Qendra Kosovare për Studime Gjinore
Kosovar Gender Studies Center

ANALIZA E ZBATIMIT

PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE (2024-2026)



KOMUNA E MITROVICËS SË JUGUT

PERIUDHA E MONITORUAR: JANAR 2024 - MARS 2025

Ky aktivitet i Mitrovica Women Association for Human Rights mbështetet nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore, përmes projektit "Monitorimi dhe llogaridhënia me ndjeshmëri gjinore"

Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e Mitrovica Women's Association for Human Rights (MWAHR) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore.

© Mitrovica Women's Association for Human Rights (MWAHR), korrik 2025

Shkurtesat

ABGJ – Agjencia për Barazi Gjinore
ASK – Agjencia e Statistikave të Kosovës
AMF – Ambulanca e Mjekësisë Familjare
BE – Bashkimi Evropian
BPGJ – Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor
CECD – Center Education and Community Development – Friends
DKA – Drejtoria Komunale e Arsimit
DMS – Drejtoria për Mirëqenie Sociale
DKRS – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
DSH – Drejtoria për Shëndetësi
DBRZH – Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillimit Rural
DEZHIE – Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integrime Evropiane
FAO – Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë
FB – Facebook (si burim i monitorimit)
GEF – Gender Equality Facility
IADK – Initiative for Agricultural Development of Kosovo
KAB – Korniza Afatmesme e Buxhetit
KQZ – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
MWAHR – Mitrovica Women's Association for Human Rights
OJQ – Organizatë Joqeveritare
OS – Objektiv Specifik
PLVBGJ – Plani Lokal i Veprimit për Barazi Gjinore
PZHK – Plani Zhvillimor Komunal
QKMF – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QAP – Qendra e Aftësimit Profesional
SO – Objektiv Strategjik
UNW – UN Women
VA – Vlerësimi Afatgjatë
VNGJ – Vlerësimi i Ndikimit Gjinor
ZBGJ – Zyrtari/ja për Barazi Gjinore
ZDNJ – Zyrtari/ja për të Drejtat e Njeriut

Tabela e Përmbajtjes

1.Hyrje 5

1.1.Përshkrimi i shkurtër i PLVBGJ 2024–2026 6

1.2. Metodologjia 7

1.3. Burimet dhe qasja në monitorim 8

2. Përmbledhje Ekzekutive 9

3. Fushat sipas Objektivave 10

3.1.Objektiva 1. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave 10

3.1.1 Objektivi Specifik 1.1 – Nxitja e pjesëmarrjes së grave në jetën publike dhe politike 11

3.1.2 Objektivi Specifik 1.2 – Integrimi gjinor në politika dhe buxhet 14

3.2. Objektiva 2. Fuqizimi ekonomik dhe promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë 19

3.2.1 Objektivi Specifik 2.1 – Rritja e qasjes në shërbime, burime dhe produkte financiare 19

3.2.2 Objektivi Specifik 2.2 – Rritja e vetëdijesimit dhe përmirësimi i qasjes në shërbimet e kujdesit 22

3.3. Objektiva 3. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsim dhe mësimin gjatë gjithë jetës 24

3.3.1 Objektivi Specifik 3.1 – Ofrimi i mundësive të barabarta në arsim dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës 24

3.3.2 Objektivi Specifik 3.2 – Promovimi i grave dhe vajzave në art, kulturë dhe sport 28

3.4. Objektiva 4. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese 31

3.4.1 Objektivi Specifik 4.1 – Qasja në shëndetin seksual dhe riprodhues 31

4. Konkluzionet 35

5. Rekomandime 36

1. Hyrje

1.1. Përshkrimi i shkurtër i PLVBGJ 2024-2026

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore (PLVBGJ) 2024–2026 i Komunës së Mitrovicës së Jugut[1] i miratuar më 31.07.2024[2] është dokumenti udhëzues dhe operacional që përcakton angazhimet konkrete për të përmirësuar gjendjen e barazisë gjinore në nivel komunal. Ky plan synon të promovojë dhe zbatojë parimet e barazisë dhe drejtësisë gjinore në të gjitha fushat e jetës publike dhe institucionale.

PLVBGJ është hartuar me mbështetjen e UN Women në Kosovë në kuadër të projektit "Gender Equality Facility" (GEF), të financuar nga Bashkimi Evropian. Ky dokument është produkt i një procesi gjithëpërfshirës të konsultimit me institucionet komunale, organizatat e shoqërisë civile, Grupin Jo Formal të Grave të Kuvendit Komunal, qytetarët dhe organizatat ndërkombëtare.

Plani përfshin katër objektiva strategjike:

1. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave;
2. Fuqizimi ekonomik dhe promovimi i të drejtave sociale, ekonomike dhe të punësimit të denjë për gratë dhe vajzat;
3. Zvogëlimi i pabarazive në arsim dhe në të mësuarit gjatë gjithë jetës;
4. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.

Çdo objektiv shoqërohet me objektiva specifikë, rezultate të pritshme, tregues matës, aktivitete konkrete, afate kohore, kosto dhe institucione përgjegjëse për zbatim. PLVBGJ integron perspektivën gjinore në planifikimin komunal dhe parasheh përdorimin e mjeteve si buxhetimi i përgjegjshëm gjinor dhe vlerësimet gjinore.

Zbatimi i planit mbështetet në ndarjen e përgjegjësive mes komunës, drejtorive të saj, institucioneve partnere, OJQ-ve dhe donatorëve. Kostoja e zbatimit është e ndarë në burime nga komuna, donatorët dhe hendeku financiar për të cilin kërkohet mobilizim shtesë përmes buxheteve vjetore dhe KAB-eve të ardhshme.

PLVBGJ 2024–2026 paraqet një mekanizëm të rëndësishëm institucional që forcon llogaridhënien dhe efikasitetin e institucioneve lokale në avancimin e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

[1] https://mitroviceejugut.rks-gov.net/dokumentet-per-konsultim-publik/
[2] https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/08/03-Vendim-Plani-lokal-i-veprimit-per-barazi-gjinore-2024-2026.pdf

1.2. Qëllimi i analizës dhe raportit të monitorimit

Qëllimi i analizës dhe raportit të monitorimit është të ofrojë një pasqyrë të qartë, të argumentuar dhe të matshme mbi ecurinë e zbatimit të Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore (PLVBGJ) në komunën e Mitrovicës së Jugut. Ky raport synon të identifikojë arritjet, sfidat dhe boshllëqet në zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara në PLVBGJ, si dhe të vlerësojë kontributin real të këtyre planeve në avancimin e barazisë gjinore.

Analiza/Raporti ka për qëllim të:

- Vlerësojë në mënyrë sistematike përputhjen e zbatimit me planin e miratuar, përfshirë përmbushjen e objektivave strategjike dhe specifike;
- Analizojë pjesëmarrjen e aktorëve lokalë, përfshirë institucionet komunale, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e margjinalizuara, në procesin e zbatimit të planit;
- Evidentojë praktikat e mira dhe pengesat që kanë ndikuar në arritjen e objektivave të barazisë gjinore;
- Sigurojë të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe kategorive të tjera të ndjeshme për të gjurmuar ndikimin real të politikave dhe masave të ndërmarra;
- Ofrojë rekomandime praktike dhe të zbatueshme për përmirësimin e mëtejshëm të zbatimit të PLVBGJ-së, në përputhje me nevojat e komunitetit dhe standardet ndërkombëtare të barazisë gjinore;
- Inkorporojë të dhënat nga diskutimi/validimi i të dhënave nga grupi punues komunal për hartimin e PLVBGJ-së.

Analiza do të shërbejë si instrument vlerësimi për arritjet dhe si bazë për përmirësimin e planifikimit dhe buxhetimit të ndjeshëm gjinor në periudhat vijuese. Gjithashtu, do të ndihmojë në fuqizimin e rolit të zyrtarëve për barazi gjinore dhe të aktorëve tjerë përkatës në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave dhe vajzave në komunitetet përkatëse.

1.3. Metodologjia

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore (PLVBGJ) në komunën e Mitrovicës së Jugut është zhvilluar përmes një qasjeje të kombinuar metodologjike që ndërthur analizën dokumenteve, punën me fokus grupe, monitorimin përmes treguesve dhe validimin të të dhënave nga grupi punues për hartimin PLVBGJ 2024–2026, me qëllim që të pasqyrojë në mënyrë sa më reale progresin, sfidat dhe ndikimin e zbatimit të planit në komunitet.

Monitorimi është i bazuar në katër qasje: i. politikat dhe financimet e zbatuara në komunë; ii. evidencat e siguruara nga dokumentet e publikuara iii. të dhënat e siguruar nga monitorimi dhe iv. te dhënat e validuara nga grupi punues për hartimin PLVBGJ 2024–2026.

Analiza e dokumenteve ka shërbyer si bazë për të shqyrtuar nivelin e përputhjes ndërmjet planeve të miratuara dhe veprimeve konkrete të ndërmarra nga komuna. Janë analizuar dokumentet kryesore strategjike dhe operative të komunës, përfshirë vetë PLVBGJ-të, Kornizat Afatmesme të Buxhetit (KAB), planet dhe rregullativën komunale, raportet e performancës dhe dokumentet buxhetore vjetore. Vëmendje e veçantë i është kushtuar pranisë së komponentëve të barazisë gjinore brenda këtyre dokumenteve, si dhe mënyrës se si parimet gjinore janë integruar në planifikim, programim dhe alokim të buxhetit.

Komponenti kryesor cilësor i metodologjisë është puna me fokus grupe, e cila është realizuar me përfaqësues/e të grupeve të synuara nga PLVBGJ-të, përfshirë gra të angazhuara në jetën publike, vajza të reja, përfaqësues/e të organizatave të grave, persona nga komunitete të margjinalizuara, si dhe përfaqësues/e të shërbimeve komunale që kanë rol në zbatimin e objektivave të planit.

Përpunimi i të dhënave është bërë përmes analizës tematike, duke u bazuar në objektivat strategjikë të PLVBGJ-së dhe duke kategorizuar gjetjet sipas fushave të ndërhyrjes. Raporti përfundimtar i monitorimit është ndërtuar mbi këtë bazë metodologjike, duke përfshirë konkluzionet, si dhe rekomandime të drejtpërdrejta për rritjen e efektshmërisë së zbatimit në fazat e ardhshme.

1.4. Burimet dhe qasja në monitorim

Analiza dhe raporti i monitorimit të zbatimit të Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore (PLVBGJ) në komunën e Mitrovicës së Jugut është bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit zyrtar komunal. Ky proces ka përfshirë vlerësimin e përputhjes ndërmjet planifikimit dhe zbatimit të masave të parapara në PLVBGJ, si dhe masat e përdorura për zbatim.

Burimet kryesore dokumentare kanë përfshirë:

- Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore të miratuar, për të analizuar strukturën e objektivave strategjikë, aktivitetet, treguesit dhe ndarjen institucionale të përgjegjësive;
- Kornizat Afatmesme Buxhetore (KAB) dhe buxhetet komunale, për të vlerësuar nëse masat e planifikuara janë reflektuar në planifikimin buxhetor të viteve përkatëse;
- Planet dhe dokumentet sektoriale (arsimi, shëndetësia, mirëqenia sociale, etj.), me fokus në integrimin e perspektivës gjinore në politikat lokale;
- Raportet vjetore të performancës të drejtorive komunale dhe raportet e zbatimit, për të identifikuar aktivitetet e realizuara që lidhen me objektivat e PLVBGJ;
- Dokumentet relevante përfshirë listat e përfituese të subvencioneve, raportet e konsultimeve publike dhe dëgjimeve buxhetore si dhe publikime nga aktivitetet publike.
- Të dhënat e marra direkt nga grupi punues për hartimin PLVBGJ 2024–2026.

Përmes kësaj metodologjie, është mundësuar një vlerësim i bazuar dokumentacion mbi shkallën e zbatimit dhe angazhimet e ndërmarra për barazinë gjinore në nivel komunal. Në bazë të përgjegjësive të ndara në për zbatimin e aktiviteteve të PLVBGJ, janë vlerësuar veprimet e ndërmarra për zbatim.

2.Përmbledhje Ekzekutive

Ky raport paraqet një vlerësim të zbatimit të Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore (PLVBGJ) për vitin 2024 dhe tre mujorin e parë 2025 në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Ai synon të analizojë nivelin e realizimit të objektivave strategjike të përcaktuara në plan, të identifikojë mangësitë në zbatim dhe të japë rekomandime për përmirësim. Analiza dhe raporti është hartuar mbi bazën e shqyrtimit të dokumentacionit zyrtar komunal, përfshirë planet strategjike, buxhetet, raportet vjetore të drejtorive, procesverbalet e kuvendit dhe dokumente të tjera përkatëse.

Nga analiza rezulton se zbatimi i planit mbetet i kufizuar. Edhe pse në fazë të hershme të zbatimit, vërehet një trend i ulët i përmbushjes. Aktivitetet e parapara nuk janë të dokumentuara, nuk ekziston ndarje buxhetore e përcaktuar për barazinë gjinore dhe mungojnë raportet e zbatimit. Zyrtari/ja për barazi gjinore është i emëruar, por pa mandat të fuqishëm ndër-sektorial, ndërkohë që Komiteti për Barazi Gjinore nuk ka ushtruar funksionin e tij gjatë vitit të parë. Barazia gjinore nuk është integruar mjaftueshëm në politikat dhe financimet komunale, ndërsa në politikat sektoriale mungojnë analiza të nevojave dhe të dhëna të ndara sipas gjinisë.

Përfaqësimi i grave në organet si administratë, udhëheqje politike dhe të zgjedhur politik mbetet i ulët. Nuk janë ndërmarrë masa specifike për përfshirjen e grave në punësim, në shërbime publike ose në programet për mirëqenie sociale. Gratë nga grupet e margjinalizuara, përfshirë ato me aftësi të kufizuara, nuk janë përfituese të drejtpërdrejta të ndonjë programi të identifikueshëm në dokumentacionin komunal. Po ashtu, mungojnë statistika gjinore dhe nuk janë të zhvilluara mekanizmat për grumbullim, përpunim dhe përdorim të të dhënave për qëllime të planifikimit dhe raportimit gjinor. Në këtë kontekst, analiza rekomandon hartimin e një plani vjetor operacional të detajuar për zbatimin e PLVBGJ, me aktivitete të detajuara, burime të ndara dhe afate të përcaktuara. Roli i zyrtarit/es për barazi gjinore duhet të fuqizohet dhe Komiteti për Barazi Gjinore duhet të funksionalizohet me mandat të qartë për mbikëqyrje dhe raportim. Barazia gjinore duhet të integrohet në të gjitha dokumentet strategjike dhe buxhetore të komunës.

Kërkohet gjithashtu ndarja dhe publikimi i statistikave të ndara sipas gjinisë dhe vendosja e indikatorëve të matshëm për secilin objektiv. Komuna duhet të krijojë mekanizma për konsultim të rregullt me organizatat e shoqërisë civile, të zhvillojë fushata për vetëdijësim dhe të ndërtojë kapacitete institucionale për të avancuar qasjen gjinore në të gjitha fushat e qeverisjes lokale. Zbatimi i këtyre masave do të përmirësonte dukshëm nivelin e përfshirjes së grave dhe vajzave në jetën publike dhe do të ndihmonte komunën ë ndërtojë një qeverisje më gjithëpërfshirëse dhe të barabartë.
Nga diskutimi validues me grupin punues pjesë e hartimit të PLVBGJ-se dolën në pah tri elemente: i. mungesa e vlerave bazë PLVBGJ për planifikim dhe vlerësim të realizimit; ii. nevoja për hartimin e një plani sektorial të zbatimit të PLVBGJ-së si dhe rolin ndër-sektorial të zyrtarit/es për barazi gjinore; dhe iii. ndërtimi i një platforme për të dhëna si dhe raportime të ndara sipas gjinisë.

3.Fushat sipas Objektivave:

3.1. Objektiva 1. promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre

Referuar statistikave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), mund të konstatohet se përfaqësimi politik mbetet i ulët, në veçanti në pozitat udhëheqëse dhe vendimmarrëse. Përderisa, nga regjistrimi i fundit i popullsisë, pothuajse struktura është e barabartë apo 50.42 (%) burra dhe 49.58 (%) gra[3], kjo nuk reflektohet edhe në përfaqësim politik e institucional, social dhe ekonomik, në veçanti në pozita vendimmarrëse. Sipas shtojcës për Buxhetim të Përgjegjshëm Gjinor[4], tek tabela e administratës komunale në Komunën e Mitrovicës së Jugut, nga 338 të punësuar, vetëm 135 apo 40.29 (%) janë gra.



Ndërkaq referuar raportit të Institutit GAP 'Punësimi dhe përfaqësimi i grave në Kosove' del se ne Komune e Mitrovicës së Jugut, nga 48 pozita udhëheqëse, vetëm 7 janë gra apo 15 (%)[5]. Në pozitat drejtuese politike, nga 18 pozita (kryetari, kryesuesi i kuvendit komunal, dhe 15 drejtori komunale), vetëm 4 janë gra apo 22.22 (%). Përfshirë Kryesuesen e Kuvendit Komunal, Drejtoreshën e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit, Drejtoreshën e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale[6].



Katërmbëdhjetë (14) Burra, 77.78 (%) Katër (4) Gra, 22.22 (%)

Në Kuvendin Komunal, nga 35 këshilltarë komunalë[7], 12 janë gra, apo 34.28 (%).


Nga 12 gra që përfaqësohen në Kuvendin Komunal:



Tetë (8) gra, 66.67 (%) kanë marrë mandat pa kuotë;



Katër (4) gra, 33.3 (%) zgjedhur me kuotën gjinore 30 (%);



[3] Agjencia e Statistikave të Kosovës, regjistrimi i popullsisë dhe ekonomive familjare 2024.
[4] https://mitroviceejugut.rks-gov.net/buxheti-2/
[5] 24031_Raporti Punësimi dhe përfaqësimi i grave në Kosovë 2019 final.pdf (institutigap.org)
[6] Për drejtoreshën e Mirëqenies Sociale, mungojnë te dhënat ne ueb faqe
[7] KQZ certifikon rezultatet përfundimtare të Zgjedhjeve për 38 Kuvendet Komunale – KQZ (kqz-ks.org)

3.1.1 Objektivin Specifik 1.1 - Nxitja e pjesëmarrjes së grave në jetën publike dhe politike

Referuar Raportit te Konsultimeve Publike për vitin 2024, Komuna e Mitrovicës së Jugut[8] ka realizuar gjithsej 9 konsultime publike dhe 5 dëgjime buxhetore (KAB dhe buxheti vjetor). Konsultimet janë zhvilluar në tri forma: takime publike me qytetarë, takime konsultative për projekt-dokumente komunale dhe dëgjime buxhetore. Konsultimet kanë përfshirë dokumente: Plani Komunal kundër Braktisjes dhe mos diskriminimit 2024–2026; Rregullorja për plotësim dhe ndryshim të Rregullores Nr. 02-2019 për tarifat, taksat dhe gjobat komunale; Harta Zonale e Komunës së Mitrovicës së Jugut 2023–2031, Projekti - Plani i Komunal për Barazi Gjinore; Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2025–2027, Projekti Buxheti Komunal 2025; Draft - Statuti i Bibliotekës Komunale të Mitrovicës; Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Mitrovicës së Jugut 2024–2027, si dhe Draft - Rregullorja për ndryshim-plotësimin e Rregullores komunale Nr.01/2022 për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratës Komunale.

Në kuadër të procesit të hartimit të KAB dhe Draft-Buxhetit, Komuna e Mitrovicës së Jugut ka organizuar një dëgjim publik për Kornizën Afat-Mesme Buxhetore dhe katër dëgjime buxhetore tematikisht të ndara për Buxhetin Vjetor Komunal. Dëgjimi i parë ka përfshirë qytetarët nga lagjet dhe fshatrat. Dëgjimi i dytë është fokusuar në fushat e kulturës, rinisë, sportit, shoqërisë civile dhe komuniteteve. Dëgjimi i tretë ka trajtuar çështjet e sektorit të shëndetësisë, ndërsa dëgjimi i katërt ka qenë i dedikuar për gratë dhe vajzat.

Konsultimet dhe Dëgjimet Publike 2024[8]

Lloji i Aktivitetit	Numri i takimeve	Pjesëmarrës gjithsej	Gratë pjesëmarrëse	Burrat pjesëmarrës
Konsultime publike	9	231	92	139
Dëgjime buxhetore	5	79	36	43
Takime publike me qytetarë	2	88	19	69

Bazuar në të dhënat e monitorimit të zbatimit për periudhën janar 2024 – mars 2025 sa i përket kësaj objektive specifike, mund të konstatohet se trendi i përgjithshëm i zbatimit është i kufizuar dhe me progres të ulët krahasuar me objektivat e planifikuara për periudhën 2024–2026. Në këtë objektiv specifike janë paraparë gjithsej nëntë aktivitete, të ndërlidhura me ngritjen e vetëdijes për pjesëmarrje të barabartë në vendimmarrje, përfshirjen e gjuhës së ndjeshme gjinore në dokumente, promovimin e të drejtave pronësore për gratë, dhe përfshirjen e grave në këshillat lokalë. Qëllimi i përgjithshëm është rritja e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre në proceset politike dhe publike, si dhe rritja e përqindjes së përfshirjes së tyre me 6% deri në vitin 2026.

[8] https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Raporti-i-Konsultimeve-publike-per-vitin-2024-Komuna-e-Mitrovices.pdf

Nga të dhënat del se, trendi i përgjithshëm i arritjes për Objektivin Specifik 1.1 mbetet nën nivelin e pritshëm për vitin 2024 dhe tremujorin e parë të vitit 2025. Megjithëse synimi është një rritje 6% e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në jetën politike dhe publike, mungesa e progresit në shumicën e aktiviteteve dhe raportimi jo i plotë për ato që janë ndërmarrë. Kjo gjendje nënvizon dy sfida kryesore: e para, është mungesa e kapaciteteve për zbatim dhe ndarje të përgjegjësive të qarta institucionale ndërmjet drejtorive; e dyta, është mungesa e dokumentimit të aktiviteteve dhe matjes së ndikimit të tyre me tregues konkretë.

Interpretimi i trendit tregon se:

- Vetëm 2 nga 9 aktivitete janë zbatuar deri në mars 2025, konkretisht aktiviteti 1.1.1 (organizimi i aktiviteteve për 8 Marsin) dhe aktiviteti 1.1.2 (aktivitetet për fushatën "16 Ditë të Aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore"). Edhe këto dy aktivitete janë zbatuar pa raportim të plotë, pa ndarje të të dhënave sipas gjinisë apo statusit social dhe pa dokumentacion shoqërues si lista të pjesëmarrjes apo raport përmbledhës;
- Aktivitetet 1.1.3 deri 1.1.9 nuk kanë shënuar progres të dukshëm gjatë vitit 2024 dhe tremujorit të parë të vitit 2025.
- Aktivitetet 1.1.5 nuk ka ndonjë progres përtej zhvillimit të trajnimit nga Agjencia për Barazi Gjinore në vitin 2023 sa i përket trajnimit të zyrtares/zyrtarit për informim, përkthyeseve/përkthyesve dhe zyrtareve/zyrtarëve të tjerë të komunës, për përdorimin e gjuhës së ndjeshme gjinor,
- Aktiviteti 1.1.6 integrimi i gjuhës së ndjeshme gjinore në dokumentet publike, ka shënuar një progres të pjesshëm në Kornizën Afat-Mesme Buxhetore (2025-2027) dhe Planin e Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, por që nuk vërehet një përfshirje sistematike dhe nuk është hartuar ndonjë analizë gjithëpërfshirëse në këtë fushë.
- Aktiviteti 1.1.7 takime me gratë dhe burrat për rritjen e pjesëmarrjes së grave në udhëheqjen e këshillave lokalë, është zbatuar në vitin 2023, por kjo është jashtë periudhës zyrtare të planifikimit dhe zbatimit të këtij cikli të PLVBGJ.
- Aktiviteti 1.1.8 dhe 1.1.9 ndonëse ekziston udhëzimi për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve[9], rregullorja e miratuar për subvencionimin e taksës së regjistrimit të pronës për gratë ende nuk kanë kaluar në fazën e zbatimit

[9]https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=101967&fbclid=IwZXh0bgNhZW0CMTAAAR3coMJH2ibXIW9vWrPuI_snWJmScg80dNcsMy4DQnU13SeyHSto2g-efSg_aem_0OsLvVSkWIM0PA_OdgBCsQ

3.1.1.1. Matrica e Monitorimit - Objektivi Specifik 1.1

Objektivi Specifik	Aktiviteti	Treguesi i Performancës	Rezultati i Arritur (2024 – Mars 2025)	Burimi i Verifikimit	Komente nga Monitorimi
1.1. Nxitja e pjesëmarrjes së grave, të rejave dhe vajzave në vendimmarrje	1.1.1 Marshime & takime për 8 Marsin	3 marshime, 3 takime, 60 pjesëmarrës	2 marshime (2024), 1 marshim (2025); mbi 400 pjesëmarrës	Foto, postime në rrjete sociale	Listat mungojnë për shkak të numrit të madh; të dhënat nuk janë të ndara sipas gjinisë;
	1.1.2 Aktivitetet për “16 Ditët”	30 sesione, 600 persona, 3 shfaqje	1 protestë, 1 performancë teatrore, deri 200 pjesëmarrës	Foto, postime, raport në media	Nuk ka ndarje sipas gjinisë/moshës; dokumentim vizual i mirë;
	1.1.3 Takime vetëdijësuese për diskriminim	6 takime, 60 persona	Nuk janë realizuar	-	Aktiviteti nuk është zbatuar; kërkohet angazhimi i Zyrës për të Drejtat e Njeriut
	1.1.4 Takime me të punësuar për ngacmim seksual	6 takime, 72 persona	Në përgatitje (parashikuar për korrik 2025)	-	Është në fazë përgatitore në partneritet me OSBE;
	1.1.5 Trajnim për gjuhën gjinore	10 persona të trajnuar	Është zhvilluar trajnim me ABGj në 2023	Raport nga ABGj	Nuk ka zbatim në këtë periudhë;
	1.1.6 Përdorimi i gjuhës gjinore në dokumente	Numri i dokumenteve të përmirësuara	KAB 2024 dhe Plani i Veprimit për PAK	Vendime komunale	Procesi nuk është sistematik; rekomandohet qasje e integruar;
	1.1.7 Takime për këshillat lokalë	8 takime, 80 pjesëmarrës	Aktivitet i mbajtur në 2023 (jo në periudhën e raportimit)	Raport 2023	I planifikuar për 2026, nuk monitorohet tani;
	1.1.8 Takime për regjistrimin e përbashkët të pronës	6 takime, minimum 18 persona në vit	Nuk janë planifikuar dhe nuk janë realizuar	-	Drejtoria nuk i ka përfshirë në planin e punës;
	1.1.9 Subvencionimi i taksës së regjistrimit të pronës	Numri i grave përfituese	Nuk ka përfituese; mungon rregullorja	-	Nevojitet hartimi i rregullores për zbatim;

3.1.2.Rritja e masave dhe veprimeve të Komunës që marrin parasysh e zbatojnë integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.

Sipas Qarkoreve të Buxhetit, të lëshuara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), çdo organizatë buxhetore është e obliguar të dorëzojë shtojcën e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, së bashku me kërkesat e tyre buxhetore[10]. Referuar Raportit te Institutit GAP, 'Barazia në letër, jo në praktikë: (mos) përdorimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë në politike bërje', tek tabela 3. Integrimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë në dokumente buxhetore sipas komunave, del se Komuna e Mitrovicës së Jugut, nuk ka bërë Vlerësimi i Ndikimit Gjinor, shtojcën e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinore, e as Kornizën Afat-Mesme Buxhetore dhe Raportin Vjetor[11].

Në përputhje me Ligjin e ri Nr. 05/L-020 për barazinë gjinore, të gjitha organizatat buxhetore pritet të integrojnë BPGJ-në në proceset dhe dokumentet buxhetore, konkretisht, neni 3.1.17 i këtij ligji parasheh a përkufizimi për BPGJ i cili thotë si vijon: "Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor është zbatimi i integrimit gjinor në procesin buxhetor". Kjo do të thotë vlerësim të buxheteve nga pikëpamja gjinore, në të gjitha nivelet e procesit buxhetor, dhe ristrukturimin e të ardhurave dhe shpenzimeve me qëllim të promovimit të barazisë për gra dhe burra." Për më tepër, neni 5.1.5 obligon të gjitha institucionet që të integrojnë BPGJ-në, duke deklaruar se institucionet janë përgjegjëse për: "përfshirja e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si mjet i nevojshëm për të garantuar se parimi i barazisë gjinore respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe shpërndarjen e burimeve." [12].

> "Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor është zbatimi i integrimit gjinor në procesin buxhetor"

Përderisa referuar Raportit te Dëgjimeve Buxhetore, përkatësisht dëgjimit të katërt buxhetor të mbajtur më 23 korrik 2024 në Komunën e Mitrovicës së Jugut, të dedikuar grave dhe vajzave, është paraqitur një numër i lartë kërkesash që reflektojnë sfidat strukturore, sociale dhe ekonomike me të cilat përballen gratë në qytet dhe zonat rurale. Kërkesat ishin të fokusuara në tre drejtime kryesore: përkrahje për gratë sipërmarrëse, përmirësim i kushteve për pjesëmarrje dhe barazi, si dhe rritje e mbështetjes për gratë nga komunitetet e margjinalizuara dhe personat me aftësi të kufizuara. Duhet theksuar se në raportin e dëgjimeve buxhetore, nuk janë paraqitur përgjigjet, statusi i kërkesës dhe sqarimi ashtu siç parasheh Udhëzimi Administrativ për Administratë të Hapur në Komunë[13], përkatësisht neni 32 Mbikëqyrja e procesit të konsultimit publik dhe raportimi 1. Komuna siguron ofrimin e përgjigjeve për statusin e propozimeve të marra nga diskutimet publike, përmes një raporti të veçantë i cili bëhet publik në ueb-faqen zyrtare të komunës, si dhe në Platformën e Qeverisë për Konsultime Publike.

[10] https://mfpt.rks-gov.net/desk/content/media/4cc4977c-06f6-4387-9bc0-037f39868696.pdf
[11] https://www.institutigap.org/documents/95399_Barazia%20ne%20leter.pdf
[12] https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20170428114117535.pdf
[13]https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=84864

Tabela – Kërkesat kryesore nga dëgjimi buxhetor për Gratë dhe Vajzat (shtojca e BPGJ)[14]

Fusha	Kërkesat Kryesore
Sipërmarrje dhe punësim	Mjete pune (frizeri, rrobaqepësi, ushqime tradicionale), kioska për shitje, përkrahje për blegtori
Promovim dhe treg	Panaire të rregullta, lokacione për shitje, grante për prodhime artizanale dhe agrobiznese
Shoqëri civile	Hapësira për organizatat e grave, grante për OJQ aktive, trajnime për zyrtarë për barazi gjinore
Gratë nga komunitetet	Bursa për vajzat e komuniteteve rome/ashkali, mbështetje për regjistrim në shkolla profesionale
Aftësi të kufizuara	Qasje në ndërtesa publike, punësim i qëndrueshëm, tualete dhe sinjalistikë për personat me nevoja të veçanta
Arsim dhe të rinj	Bursa, trajnime profesionale, kuzhina shkollore, psikologë në shkolla, përkrahje për vajzat në zonat rurale
Infrastruktura publike	Rregullim rrugësh (Broboniq, Kristalet), ndriçim në “Adem Voca”, zyre për të verbër dhe ambient për pensionistët
Mbështetje sociale	Përkrahje për strehimore, gratë me kancer, vazhdim i pagesave të qirasë, ndihmë ushqimore dhe financiare

Bazuar në të dhënat e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ)[14], administrata komunale ka 335 të punësuar, prej tyre 135 gra (40.3%) dhe 199 burra (59.4%). Shuma e përgjithshme e pagave është 2,004,000 euro, nga të cilat 810,000 euro për gratë (40.4%) dhe 1,194,000 euro për burrat (59.6%).Në nivelin e pagave 201–400 euro janë të punësuar 10 persona, nga të cilët 5 gra dhe 5 burra. Në nivelin 401–600 euro janë 174 të punësuar, 79 gra dhe 95 burra. Në nivelin më të lartë, 600+ euro, janë 131 të punësuar, vetëm 35 gra dhe 96 burra. Në këtë kategori, burrat përfitojnë trefishin e shumës në krahasim me gratë, me mbi 81 mijë euro kundrejt 25 mijë eurove për gratë. Kjo tregon se gratë mbesin të përqendruara në nivelet e ulëta e të mesme të pagave, ndërsa burrat dominojnë në pozitat me paga të larta, duke reflektuar pabarazi të theksuar në mundësitë për avancim dhe shpërblim. Kërkohet rishikim i politikave të brendshme për të siguruar qasje të barabartë gjinore në të gjitha nivelet.

Të dhënat referuar Shtojcës së Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor[15]

Administrata Komunale

Treguesi	Totali	Gra	Burra	% gra	% burra
Numri total i stafit	335	135	199	40.30%	59.40%
Shuma e përgjithshme	2,004,000.00	810,000.00	1,194,000.00	40.40%	59.60%

[14] https://mitroviceejugut.rks-gov.net/buxheti-2/
[15] Po aty

Ndarja sipas niveleve të pagave[16]

Niveli i pagës	Nr. Total	Gra	Burra	Shpenzime për gra (€)	Shpenzime për burra (€)
201–400	10	5	5	1,025.11	1,252.24
401–600	174	79	95	42,495.10	48,550.74
600+	131	35	96	25,781.81	81,082.14
Totali	315	119	196	69,302.02	130,885.12

Bazuar në të dhënat e monitorimit të zbatimit për periudhën janar 2024 – mars 2025, vërehet një zbatimit i pjesshëm dhe mungesë të qasjes së koordinuar ndërinstitucionale për të avancuar integrimin gjinor në ciklin e planifikimit dhe buxhetimit komunal. Në këtë objektiv janë paraparë gjithsej tetë aktivitete, të ndërlidhura me trajnimin e zyrtarëve për integrim gjinor, zbatimin e analizës gjinore në programet buxhetore, promovimin e pjesëmarrjes së grave në dëgjime publike, krijimin e një hapësire të dedikuar për barazinë gjinore në faqen zyrtare të komunës, dhe mbledhjen e të dhënave për treguesit matës të planit. Qëllimi i përgjithshëm është krijimi i një kornize institucionale që garanton integrimin e parimeve të barazisë gjinore në planifikimin, buxhetimin, dhe në proceset vendimmarrëse lokale.

Nga të dhënat del se, trendi i përgjithshëm i arritjes për Objektivin Specifik 1.2 mbetet dukshëm nën nivelin e pritshëm për periudhën janar 2024 – mars 2025. Mungesa e një analize buxhetore me perspektivë gjinore dhe pamundësia për të matur përqindjen e buxhetit të dedikuar për barazinë gjinore, tregon se synimi për të integruar në mënyrë substanciale perspektivën gjinore në politikat dhe buxhetin komunal mbetet ende në fazë të hershme. Kjo gjendje vë në pah tri sfida kryesore: e para, është mungesa e një koordinimi efektiv institucional për të ndarë përgjegjësitë në zbatimin e objektivit; e dyta, është mungesa e dokumentacionit të saktë dhe të matshëm që do të mundësonte monitorim të qëndrueshëm; dhe e treta, është mungesa e vlerave bazë për treguesit.

[16] https://mitroviceejugut.rks-gov.net/buxheti-2/

Interpretimi i trendit tregon se:

- Vetëm 2 nga 8 aktivitete janë zbatuar plotësisht deri në mars 2025 – konkretisht aktiviteti 1.2.1 (trajnim për integrimin gjinor), i zhvilluar në dhjetor 2024 me pjesëmarrjen e 15 zyrtarëve komunalë. Aktiviteti ka ndikuar pozitivisht në ngritjen e kapaciteteve, por qe ende nuk ka ndonjë rezultat të matshëm në politikat dhe financimet komunale; dhe Aktiviteti 1.2.2 (trajnim për buxhetim të përgjegjshëm gjinor) është realizuar 2025. Aktiviteti ende nuk është shoqëruar me masa përcjellëse për aplikimin praktik të koncepteve të mësuara;
- Aktiviteti 1.2.3 (zbatimi i analizës gjinore në programet buxhetore) nuk është realizuar për vitin 2024. Është përdorur dokumentacion i viteve të mëparshme, duke e kufizuar ndikimin real të këtij aktiviteti në strukturën buxhetore;
- Aktiviteti 1.2.4 (takime për pjesëmarrjen e grave në dëgjime publike) është zbatuar pjesërisht me dy takime të zhvilluara në vitin 2024, me gjithsej 67 pjesëmarrës. Megjithatë, mungon një analizë e thelluar e ndikimit dhe dokumentacion i plotë për të vlerësuar rezultatet;
- Aktiviteti 1.2.5 (mbledhja e të dhënave për treguesit e planit) është në fazë të hershme dhe nuk është finalizuar. Mungesa e vlerave bazë e bën të pamundur monitorimin efektiv të përparimit drejt objektivave të përcaktuara;
- Aktiviteti 1.2.6 (krijimi i vegëzës për Barazinë Gjinore në faqen komunale) është në përgatitje, por gjatë vitit 2024 nuk ka qenë funksional, duke pamundësuar transparencën dhe komunikimin me publikun për temat e barazisë gjinore;
- Aktiviteti 1.2.7 (takime koordinuese me OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare) nuk është realizuar. Mungesa e këtyre takimeve ka ndikuar negativisht në bashkëpunimin ndër-sektorial dhe në përthithjen e përvojave të mira;
- Aktiviteti 1.2.8 (publikimi i raporteve të monitorimit) nuk është zbatuar, duke krijuar boshllëk në vlerësimin e zbatimit dhe nevojën për ri-shikim.

3.2.1.1. Matrica e Monitorimit - Objektivi Specifik 1.2

Objektivi Specifik	Aktiviteti	Treguesi i Performancës	Rezultati i Arritur (2024 – Mars 2025)	Burimi i Verifikimit	Komente nga Monitorimi
1.2. Rritja e masave dhe veprimeve komunale për integrim dhe buxhetim gjinor	1.2.1 Trajnime për integrimin gjinor në politika publike	3 trajnime, 12 zyrtarë për trajnim	1 trajnim (2024), 15 pjesëmarrës (11 gra, 4 burra)	UN Women, lista pjesëmarrjeje	Të dhënat të ndara sipas gjinisë;
	1.2.2 Trajnime për buxhetim të përgjegjshëm gjinor	3 trajnime, 12 zyrtarë për trajnim	1 trajnim (2025), 15 pjesëmarrës	UN Women, janar 2025	Mungojnë ndarjet sipas gjinisë dhe pozitës;
	1.2.3 Analiza gjinore e programeve buxhetore	Numri i programeve të analizuara	Analizë në KAB 2024–2025 dhe 2025–2027	Raport UN Women, dokumente KAB	Bazohet në analiza të mëhershme; nevojitet përditësim;
	1.2.4 Takime për pjesëmarrjen e grave në dëgjime publike	9 takime, 90 pjesëmarrës	2 takime (2024), 66 pjesëmarrës (64 gra)	Foto, lista, postime në rrjete sociale	Mungojnë ndarjet për gjini, etni dhe moshë;
	1.2.5 Mbledhja e të dhënave bazë për treguesit	Lista e treguesve me vlerat bazë	Procesi ka filluar në qershor 2024	Procesverbal i takimit 18.06.2024	Në progres; duhet përfunduar për të gjithë treguesit;
	1.2.6 Shtimi i vegëzës për barazi gjinore në uebfaqe	Vegëza e publikuar dhe e përditësuar	Vegëza është krijuar në qershor 2024	Zyra e IT, komunikim me ZBGJ	Përmbajtja nuk është përditësuar rregullisht;
	1.2.7 Takime koordinuese me OJQ dhe organizata ndërkombëtare	3 takime, 15 pjesëmarrës për takim	Nuk janë mbajtur	-	Vetëm dëgjime publike të përgjithshme; aktiviteti mungon;
	1.2.8 Publikimi i gjetjeve nga monitorimi i PLVBGJ	Numri i raporteve të publikuara	Nuk është publikuar raporti	-	Gjetjet e monitorimit nuk janë bërë publike ende;

3.2. Objektivi 2. Fuqizimi ekonomik dhe promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, për gratë, të rejat dhe vajzat, në të gjithë diversitetin e tyre

3.2.1. Rritja e qasjes së të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime, burime dhe produkte financiare, duke synuar fuqizimin ekonomik të tyre.

Bazuar në të dhënat e monitorimit të zbatimit për periudhën janar 2024 – mars 2025, edhe pse në fazë të hershme, vërehet se ndikim mbetet i kufizuar në drejtim të fuqizimit real ekonomik të grave dhe të rejave në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Objektivi ka për synim të përmirësojë qasjen e grave në mbështetje institucionale, subvencione, trajnime dhe iniciativa për ndërmarrësi, përmes instrumenteve të qarta financiare, përkrahjes teknike dhe veprimeve afirmative në skemat e zhvillimit rural dhe urban. Treguesi për matjen e këtij rezultati është përqindja e grave përfituese në raport me burrat në programet komunale të subvencionimit në bujqësi dhe zhvillim rural, por gjatë periudhës së raportimit nuk është përdorur një sistem i rregullt dhe i detajuar i matjes së këtij treguesi.

Në këtë objektiv janë paraparë gjithsej nëntë aktivitete, të ndërlidhura me shpërndarjen e pajisjeve bujqësore, skemat e subvencionimit për kultivim dhe përpunim, trajnime për rritjen e kapaciteteve, përkrahje për start-up dhe grante për bizneset e grave. Qëllimi i përgjithshëm është krijimi i një mjedisi mbështetës ku gratë të kenë mundësi të barabarta për të ndërtuar dhe forcuar pjesëmarrjen e tyre në ekonomi, veçanërisht në sektorin e bujqësisë dhe prodhimit vendor. Referuar të dhënave del, trendi i përgjithshëm i arritjes për Objektivin Specifik 2.1 mbetet nën nivelin e pritshëm për vitin 2024 dhe tremujorin e parë të vitit 2025. Rezultatet janë të kufizuara në disa aktivitete specifike, të cilat janë realizuar me ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë dhe kanë përfshirë komponentë këshillimi dhe ndërgjegjësimi. Megjithatë, pjesa më e madhe e subvencioneve dhe skemave bujqësore mbetet e dominuar nga burrat, me mungesë të qasjes gjithëpërfshirëse për të nxitur pjesëmarrjen e grave. Kjo gjendje thekson nevojën për një analizë gjinore të plotë dhe të përditësuar në dizajnimin e skemave subvencionuese, vendosjen e kuotave të drejtpërdrejta për gratë, përmirësimin e sistemit të mbledhjes dhe publikimit të të dhënave të ndara sipas gjinisë, dhe ndërmarrjen e fushatave informuese të synuara për gratë në zonat rurale.

Interpretimi i trendit tregon se:

- Vetëm 3 nga 9 aktivitete kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë dhe pozitiv në fuqizimin ekonomik të grave dhe të rejave. Konkretisht, aktiviteti 2.1.6 (trajnimet nga FAO dhe UN Women), aktiviteti 2.1.7 (promovimi i produkteve lokale përmes OJQ-ve të grave dhe pjesëmarrjes së tyre në panaire), dhe aktiviteti 2.1.9 (grante të dedikuara për gratë dhe sesione këshilluese) janë zbatuar në përputhje me objektivat dhe kanë pasur përfshirje të gjerë të grave.
- Aktivitetet 2.1.1 deri 2.1.4 tregojnë pabarazi të theksuar gjinore në përfitimet e dhëna (aktiviteti 2.1.1), vetëm 5 gra kanë përfituar; në aktivitetin për ngritjen e pemishteve (2.1.4), të gjithë përfituesit kanë qenë burra, duke reflektuar mungesën e kuotave apo masave afirmative. Në të kundërt, në aktivitetin 2.1.2 (serat tunel), nga 5 përfitues, 3 ishin gra, dhe në 2.1.3 (bletaria), 17 nga 81 përfitues ishin gra – përfaqësim më i mirë, por ende larg barazisë.
- Aktiviteti 2.1.5 (subvencionimi i pikave përpunuese) nuk është realizuar në vitin 2024, ulur potencialin e përfshirjes së grave në sektorin e përpunimit të prodhimeve bujqësore dhe krijimin e vlerës së shtuar.
- Aktiviteti 2.1.8 (mbështetja për start-up) tregon ndarje të barabartë në përgatitje të praktikantëve, por jo në financim: vetëm 2 nga 6 përfitues të fondeve kanë qenë gra.

Të dhënat për subvencionet komunale në vitin 2024[15], referuar shtojcës se BPGJ, projektohen për një ndarje formalisht të barabartë mes grave dhe burrave, si në numrin e përfituesve ashtu edhe në buxhet. Megjithatë, përtej kësaj qasje formale në numra, del në pah një pabarazi strukturore: burrat dominojnë në përfitimin nga mbështetjet kapitale si pajisje bujqësore, pemishte dhe puse, ndërsa gratë përfitojnë kryesisht nga trajnime dhe projekte të vogla. Kjo ndarje vjen jo vetëm nga kriteret e subvencionimit, por edhe si pasojë e faktit që gratë zotërojnë më pak pronë, çka i përjashton automatikisht nga shumë skema mbështetjeje që kërkojnë pronësi si kusht.

Subvencionet dhe Përfituesit sipas Gjinive (2024) – Shtojca e BPGJ[17]

Viti	Thirrje	Numri i përfituesve	Numri i përfituesve	Numri i përfituesve	Buxheti për gra (€)	Buxheti për burra(€)
2024	137	3,750	1,875	1,875	613,830	613,829

[17] https://mitroviceejugut.rks-gov.net/raport-i-granteve-dhe-subvencioneve-per-vitin-2024/

Mbështetja në Bujqësi dhe Zhvillim Rural (DBZHR)[18]

Nr.	Aktiviteti	Gra	Burra	Totali	Komente
1	Mekanizma bujqësorë (motokultivator	5	123	128	Bashkëfinancim me Islamic Relief
2	Sera bujqësore (1–5 ari)	3	2	5	40% gra – 60% burra
3	Pajisje për bletari	17	64	81	3 koshere secili, bashkëfinancim 10% komuna
4	Pemishte me fidanë dhe ujitje	0	21	21	100% nga komuna
5	Panele solare (me Islamic	1	4	5	Projekti me partneritet
6	Puse për ujë të pijshëm (me Katarin)	5	11	16	Totali 55,000€ bashkëfinancim

Trajnime, Promovim Produktesh dhe Panaire[19]

Nr.	Aktiviteti	Gra	Burra	Totali	Komente
1	Trajnime në bujqësi (FAO/ SMART)	107	13	120	Fuqizim i grave rurale
2	Promovim i produkteve në panaire (OJQ lokale dhe IADK)	35	6	41	Mbështetje me grante/panaire
3	Start-up për të rinj/gra (PREDA & Komuna)	5	7	12	6 përfitues/2 gra dhe 6 praktikantë me pagesë

Mbështetje për Biznese të Grave (DEZHTIE)[20]

Nr.	Aktiviteti	Gra	Burra	Totali	Komente
1	Grante për biznese të grave	10	-	10	Për vitin 2024 (të tjerat – këshillime/orientim në karrierë)

[18] https://mitroviceejugut.rks-gov.net/buxheti-2/
[19] https://mitroviceejugut.rks-gov.net/buxheti-2/
[20] https://mitroviceejugut.rks-gov.net/raport-i-granteve-dhe-subvencioneve-per-vitin-2024/

3.2.2 Objektivin Specifik 2.2 - Rritja e vetëdijesimit dhe përmirësimi i qasjes në shërbimet e kujdesit

Bazuar në të dhënat e monitorimit të zbatimit për periudhën janar 2024 – mars 2025, vlerësohet se realizim i aktiviteteve në përmirësimin e shërbimeve të përkujdesjes për gratë dhe grupet cenueshme mbetet i kufizuar. Objektivi ka për qëllim krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës të përkrahjes sociale për gratë dhe vajzat në nevojë, përmes zhvillimit të qendrave të kujdesit, ndihmës sociale dhe mbështetjes institucionale për viktimat e dhunës dhe familjet me gjendje të rënduar ekonomike. Në këtë objektiv janë paraparë gjithsej gjashtë aktivitete, të ndërlidhura me ofrimin e ndihmës materiale për nënat vetushqyese dhe të moshuarat, ngritjen e qendrës për të moshuarit dhe për fëmijët, funksionalizimin e strehimores për viktimat e dhunës, mbështetjen për pagesat e qirasë për raste sociale, dhe ndihmën e njëhershme për familjet me asistencë sociale. Qëllimi i përgjithshëm është sigurimi i një baze funksionale të shërbimeve sociale që lehtëson pjesëmarrjen e grave në jetën ekonomike dhe shoqërore.

Bazuar në këtë situatë, trendi i përgjithshëm i arritjes për Objektivin Specifik 2.2 mbetet nën nivelin e pritshëm për periudhën janar 2024 – mars 2025. Mungesa e zbatimit të projekteve kyçe si qendrat për fëmijë dhe për të moshuarit, si dhe mos funksionalizimi i strehimores, vënë në pah mungesën e një strategjie të koordinuar dhe të financuar për zhvillimin e shërbimeve të kujdesit gjinor në komunën e Mitrovicës së Jugut. Kjo gjendje vë në pah tri sfida kryesore: e para, është mungesa e buxhetimit të qëndrueshëm për zhvillimin e infrastrukturës sociale të dedikuar për gratë dhe grupet e ndjeshme; e dyta, është mungesa e raportimit dhe e dokumentacionit për aktivitetet e realizuara, duke pamundësuar matjen reale të progresit dhe vlerësimin e ndikimit; dhe e treta, vërehet mungesa e bashkërendimit ndërinstitucional ër të avancuar shërbimet e kujdesit si një prioritet zhvillimor lokal.

Interpretimi i trendit tregon se:

- Vetëm 2 nga 6 aktivitete janë zbatuar në mënyrë të strukturuar deri në mars 2025. Konkretisht, aktiviteti 2.2.1 (mbështetje me pako ushqimore dhe higjienike për nëna vetushqyese dhe të moshuar) ka arritur të shpërndajë mbi 250 pako me ndihmën e 11 OJQ-ve partnere. Ky është një pozitiv i mirë i përkrahjes sociale të orientuar dhe me bashkëpunim ndër-sektorial. Gjithashtu, aktiviteti 2.2.5 (pagesa e qirasë për raste sociale) ka mbështetur 21 familje me raportim të detajuar sipas muajit, megjithatë, mungon një analizë e ndarë sipas gjinisë dhe kategorive sociale për të vlerësuar ndikimin tek gratë dhe vajzat.
- Aktiviteti 2.2.2 (ngritja e qendrës për të moshuarit) nuk ka pasur asnjë zhvillim të raportuar gjatë vitit 2024, për shkak të mungesës së planifikimit dhe buxhetimit nga drejtoria përkatëse. Kjo tregon mungesë të koordinimit dhe prioritetit për çështjet e kujdesit ndaj të moshuarve.
- Aktiviteti 2.2.3 (ngritja e qendrës për fëmijë) është përkrahur nga Ministria me 150,000 euro, por nuk ka pasur raportim mbi zhvillimet nga komuna;
- Aktiviteti 2.2.4 (funksionalizimi i strehimores për viktimat e dhunës) është në fazën përfundimtare të infrastrukturës, por nuk është funksional për shkak të mungesës së stafit, mirëmbajtjes dhe buxhetit të nevojshëm.
- Aktiviteti 2.2.6 (ndihma e njëhershme për familjet me asistencë sociale) është zbatuar vetëm për një rast të strehimit gjatë vitit 2024, duke treguar mbulim shumë të kufizuar dhe mungesë efektiviteti në përmbushjen e nevojave të komunitetit.

Subvencionet Shëndetësi dhe Përfituesit sipas Gjinive (2024) – Shtojca e BPGJ[21]

Gjinia	Numri i përfituesve	Përqindja	Buxheti (€)	Përqindja
Gra	594	60.40%	60,420	61.00%
Burra	389	39.60%	38,580	39.00%
Totali	983	100%	99,000	100%

[21] https://mitroviceejugut.rks-gov.net/buxheti-2/

3.4.1.1. Matrica e Monitorimit - Objektivi Specifik 2.2

Objektivi Specifik	Aktiviteti	Treguesi i Performancës	Rezultati i Arritur (2024 – Mars 2025)	Burimi i Verifikimit	Komente nga Monitorimi
2.2. Rritja e vetëdijesimit dhe përmirësimi i qasjes në shërbimet e kujdesit	2.2.1 Mbështetje me paketa ushqimore dhe higjienike	Numri i përfituesve çdo vit	264 persona, 11 OJQ, mbi 190,000€ ndihma direkte	Lista, FB foto, raporte me OJQ	Të dhënat nuk janë të ndara sipas gjinisë, moshës, statusit
	2.2.2 Ngritja e qendrës për të moshuarit	Qendra funksionale dhe shërbime aktive	Nuk është iniciuar; drejtoria nuk është përgjegjëse	-	Pa qartësi institucionale; mungesë përgjegjësie
	2.2.3 Ngritja e qendrës për fëmijët	Qendra funksionale dhe shërbime aktive	Në planifikim; 150,000€ të ndara nga ministria përgjegjëse	FB postime, komunikata	Proces në zhvillim;
	2.2.4 Funksionalizimi i strehimores për viktima të dhunës	Strehimore funksionale dhe 10 të punësuar	Jo funksionale; mungon rrethimi, inventari; kontakt me UNMIK pa përgjigje	Vizita në terren, komunikim me donatorët	Proces i ngadalësuar, mungesë fondesh dhe lejeje për fondet shtesë
	2.2.5 Pagesa e qerasë për raste sociale	Numri i rasteve të mbështetura dhe vlera	34 familje (2024–2025); mbi 24,000€	Lista përfituesish, dokumente financiare, FB postime	Të dhënat jo të ndara sipas kritereve gjinore apo statusit social
	2.2.6 Ndihma e njëhershme për familjet me asistencë sociale	Numri i familjeve përfituese dhe vlera	Të dhënat e plota mungojnë; 1 strehim social është ndarë	-	Nevojitet sistem më i strukturuar i raportimit dhe klasifikimit të përfituesve

3.3. Objektiva 3. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsimin cilësor dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, për gratë dhe burrat, të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre

3.3.1. Ofrimi i mundësive të barabarta për arsim cilësor e të mësuarit gjatë gjithë jetës, për vajzat, të rejat, gratë dhe djemtë, të rinjtë, burrat e Komunës, në të gjithë diversitetin e tyre.

Bazuar në të dhënat e monitorimit të zbatimit për periudhën janar 2024 – mars 2025, vlerësohet një progres i ngadaltë për plan trevjeçar. Ky objektiv ka për qëllim eliminimin e pengesave strukturore dhe sociale që kufizojnë qasjen në arsim për vajzat, të rejat dhe gratë, duke përfshirë elemente si orientimi në karrierë, mbështetja për arsim profesional, dhe mundësia për zhvillim përmes arsimit joformal. Aktivitetet synojnë gjithashtu vetëdijesimin mbi çështje si dhuna kibernetike, trafikimi dhe bullizmi në shkolla, si dhe përmirësimin e kushteve infrastrukturore për një mjedis më të barabartë arsimor.

Interpretimi i trendit tregon se:

- Vetëm 2 nga 14 aktivitete janë zbatuar pjesërisht gjatë periudhës raportuese – përkatësisht aktiviteti 3.1.5 (trajnimet mbi martesat e hershme) dhe aktiviteti 3.1.13 (arsimi joformal për gratë dhe vajzat). Megjithatë, edhe këto janë zbatuar pa ndarjen statistikore të pjesëmarrësve sipas gjinisë dhe pa raportim të plotë, gjë që e bën të vështirë vlerësimin e ndikimit.
- 4 aktivitete të tjera (3.1.3, 3.1.5, 3.1.6 dhe 3.1.7) janë realizuar pjesërisht përmes Qendrës për Punë Sociale dhe organizatave partnere si Save the Children, dhe CECD.
- 8 aktivitete të tjera (duke përfshirë trajnimin e mësimdhënësve, ndarjen e bursave, analizat mbi shkollat profesionale, organizimin e festivaleve) nuk kanë shënuar progres për shkak të mungesës së buxhetit, mungesës së stafit të dedikuar apo mbështetjes administrative. Kjo përfshin edhe aktivitete kyçe si përshtatja infrastrukturore e shkollave dhe analiza gjinore në orientimin profesional.
- · Për më tepër, nuk janë zhvilluar as takime të integruara ndërmjet drejtorive relevante për të koordinuar zbatimin e këtyre aktiviteteve, çka tregon për një boshllëk në strukturën drejtuese dhe mungesën e një mekanizmi të integruar mbikëqyrës. Bazuar në këtë situatë, trendi i përgjithshëm i arritjes për Objektivin Specifik 3.1 është shumë i ulët dhe nën nivelin e pritshëm për periudhën janar 2024 – mars 2025. Përkundër synimit për përmirësimin e qasjes së grave dhe vajzave në arsim, realizimi në praktikë ka qenë i pamjaftueshëm.

Kjo situatë nënvizon tri sfida kryesore: i. Mungesa e buxhetit të dedikuar për aktivitetet gjinore në sektorin e arsimit dhe mungesa e planifikimit buxhetor afatmesëm për qëllime të barazisë në edukim; ii. Mungesa e kapaciteteve institucionale dhe ndarjes së përgjegjësive midis drejtorive dhe njësive implementuese; iii. Mungesa e sistemit të monitorimit dhe matjes së përparimit sipas treguesve të përcaktuar – nuk ka ndarje sipas gjinive, grupmoshave dhe statusit social për të parë ndikimin në grupet në nevojë.
Referuar të dhënave të ASK, për numrin e mësimdhënësve sipas përkatësisë gjinore, vitit (2023/2024), dhe komuna, del se nga 911 mësimdhënës, 208 janë burra, apo 22.83 (%), dhe703 gra, apo 71.17 (%).

Planifikimi për vitin (2024) Niveli i pagave në Komunë, Drejtoria e Arsimit (Shtojca BPGJ)[22]

Përshkrimi	Gra	Burra	Totali
Numri i stafit	819	448	1,267
Përqindja (%)	64.64%	35.36%	100%
Paga dhe mëditje (€)	6,295,704.75	3,436,117.74	9,731,822.49

Bazuar në strukturën dhe të dhënat e planifikuara për vitin 2025, më poshtë është tabela krahasuese për nivelet e pagave, ndarë sipas gjinisë, me numra dhe përqindje:

Tabela krahasuese – Nivelet e pagave sipas gjinisë | Viti 2025 (Shtojca BPGJ)[23]

Niveli i pagave	Numri i burrave	Shuma për burra (€)	Numri i grave	Shuma për gra (€)
401–600	170	1,343,340.00	110	869,222.00
600+	290	2,291,586.00	721	5,697,352.00
Totali	**460**	**3,634,926.00**	**831**	**6,566,574.00**

Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë dhe ekonomive familjare 2024, është paraqitur Tabela. 4.8 – Popullsia e moshës 10 vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimimit më të lartë të përfunduar, gjinisë dhe komunës[24].

[22] https://mitroviceejugut.rks-gov.net/buxheti-2/
[23] Po aty
[24] https://askapi.rks-gov.net/Custom/0657ff3e-ae62-4e85-a713-e6b55cc5b335.pdf

Populllsia e moshës 10 vjeçe e mbi sipas nivelit të arsimimit më të lartë të përfunduar, gjinisë dhe komunës [25]

Niveli i arsimimit	Vajza/Gra	Djem/Burra
Nuk ka arsim formal	1206	538
Nuk ka asnjë nivel të përfunduar	732	596
4 klase sistemin e vjetër	2364	471
5 klase sistemin e ri	2210	2299
8 klase sistemin e vjetër	6519	3193
9 klase sistemin e ri	2236	2347
12 klase sistemin e vjetër	3314	6732
13 klase sistemin e ri	4884	7546
Shkolla e larte	202	410
Fakulteti (bachelor)	3209	2772
Niveli Master	726	773
Doktoraturë	26	86
Tjetër	80	106

Komuna e Mitrovicës se Jugut, nuk ka ndarë bursa për shkollat e mesme profesionale, me fokus për nxitjen e vajzave. Ndërkaq nga lista e bursave të ndara për student, del se nga 289 bursa të ndara, 228 janë vajza dhe gra, apo 71.51 (%).

Lista e përfituesve të bursës komunale për vitin akademik 2024-2025 [26]

Përfituesit e bursave për student	Djem	%	Vajza	%
	70	22.49	228	71.51

[25] https://askapi.rks-gov.net/Custom/b45ea5db-09d5-4c97-9258-9d262cd8216f.pdf
[26]https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/02/Vendim-per-perzgjedhjen-e-perfituesve-te-bursave-per-studente-2024-2025.pdf

3.3.1.1. Matrica e Monitorimit - Objektivi Specifik 3.1

Objektivi Specifik	Aktiviteti	Treguesi i Performancës	Rezultati i Arritur (2024 – Mars 2025)	Burimi i Verifikimit	Komente nga Monitorimi
3.1. Ofrimi i mundësive të barabarta për arsim cilësor e të mësuarit gjatë gjithë jetës	3.1.1 Sesione informuese për orientimin në karrierë	9 sesione, 270 pjesëmarrës	Nuk janë mbajtur – mungesë buxheti	-	Nevojitet planifikim më i mirë buxhetor
	3.1.2 Pajisja me materiale për sesione orientuese	1500 sete (500/vit)	Nuk ka informacion;	-	Nuk ka të dhëna për furnizim apo shpërndarje
	3.1.3 Takime informuese për orientim profesional	270 sesione, 5400 pjesëmarrës	Disa aktivitete nga Save the Children; Policia në Komunitet	Foto, postime të pjesshme	Të dhënat nuk janë të strukturuara, mungojnë lista
	3.1.4 Bursa për shkollën teknike (masa afirmative për vajza)	25 bursa në vit, 250 €/bursë	Nuk janë ndarë – mungesë buxheti, rregullore e aprovuar	Rregullore e bursave	Rekomandohet ndarje graduale me pilotim fillestar
	3.1.5 Aktivitet me prindër dhe nxënës për normat gjinore dhe	10 sesione, 200 pjesëmarrës	Planifikuar në koordinim me QPS, CECD Friends	-	Mungojnë sesionet; planifikuar për 2025
	3.1.6 Aktivitet mbi dhunën kibernetike dhe aspektet gjinore	2 sesione, 60 pjesëmarrës	Ka ndodhur, por jo me fokus gjinor	Postime policia në komunitet	Nevojitet shtesë trajnim mbi aspektet gjinore
	3.1.7 Aktivitet për trafikimin e grave dhe vajzave	24 sesione, 720 pjesëmarrës	Disa aktivitete janë realizuar	FB CECD Friends, postime	Mungojnë ndarjet sipas gjinisë/etnisë; dokumentimi i
	3.1.8 Aktivitet mbi bullizmin dhe dhunën në shkolla	2 sesione, 60 pjesëmarrës	Po, nga OJQ CECD	Raporte OJQ	Duhet përforcuar roli i komunës në mbështetje
	3.1.9 Analiza e kushteve për nyjet sanitare dhe qasjen	Studimi i përfunduar	Në përfundim	-	Rezultatet ende jo të publikuara
	3.1.10 Përshtatja e objekteve shkollore sipas studimit	Numri i objekteve të përshtatura	Nuk ka informacion;	-	Ende nuk ka implementim konkret
	3.1.11 Analizë e drejtimit profesional për vajzat	Raport i përfunduar	Nuk ka informacion;	-	Analiza ende nuk ka filluar
	3.1.12 Trajnim për arsimtare gra për pozita udhëheqëse	1 trajnim në vit, 25 mësuese	Nuk ka informacion;	-	Aktiviteti nuk ka filluar
	3.1.13 Arsim joformal për klasat 1–9 (me fokus vajzat)	Numri i përfitueseve	2024: 12 pjesëmarrës (8 vajza); 2025: 11 pjesëmarrës (7 vajza)	Raporte nga edukimi jo formal	Realizuar pjesërisht nga viti i tretë i programit
	3.1.14 Festival për aftësimin e vajzave në TIK	Rreth 100 vajza në vit	Nuk ka informacion;	-	Nuk ka pasur aktivitet deri tani

3.3.2.1. Promovimi i modeleve të suksesshme të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, që investojnë dhe marrin pjesë aktivisht në art, kulturë dhe sport.

Referuar te dhënave nga Raporti i Performances së Komunave, në fushën e kulturës, rinise dhe sportit përkatësisht indikatorët: 5.1.1 Hapësira për aktivitete të sportit për numër të banorëve, ka përmbushje 56.61 (%) ndërkaq 5.2.1 Aktivitete të kulturës, rinisë dhe sportit të organizuara me buxhet komunal 100 (%)[27].

Fusha 5 – Kulturë, Rini dhe Sport, në kuadër të kësaj fushe maten aktivitetet komunale kulturore, rinore dhe sportive, si një nga kompetencat vetanake të komunave. Fusha mbulon edhe shërbimet e ofruara nga komunat që kanë të bëjnë me kulturën, rininë dhe sportin, përfshirë hapësirat sportive. Fusha matë performancën duke e krahasuar me numrin e banorëve për arsye që të jetë më e balancuar ndaj komunave me shumë banorë dhe atyre me më pak banorë[28].

Referuar raportit nga dëgjimet buxhetore (2024), gjatë dëgjimit të dytë buxhetor të mbajtur më 17 korrik 2024 në Komunën e Mitrovicës së Jugut[29], i dedikuar fushës së kulturës, rinisë, sportit, shoqërisë civile dhe komuniteteve, qytetarët dhe përfaqësuesit e klubeve sportive paraqitën një numër kërkesash konkrete që reflektojnë nevojat aktuale të grupeve të tyre. Theksi kryesor i kërkesave ishte përkrahja më e madhe financiare për sportin, barazi në ndarjen e subvencioneve për klubet sportive, përmirësimi i infrastrukturës sportive dhe kulturore, si dhe përfaqësimi i të rinjve dhe transparenca në procesin e përzgjedhjes së përfituesve të subvencioneve.

Tabela – Kërkesat kryesore nga dëgjimi buxhetor për Kulturë, Rini, Sport dhe Komunitete

Fusha	Kërkesat Kryesore
Sport – Gratë	Mbështetje për KF Mitrovica – Femrat në garat evropiane; rritje e fondeve për sportet e femrave
Sport – Përgjithshëm	Subvencione për klubet Trepça, KH Trepça, veteranët; rinovim i palestrës “Omnisport”
Kulturë	Renovimi i qendrës së kulturës; diplomaci kulturore; ekspozitë për piktorë
Rini dhe OJQ	Përfaqësim i të rinjve në komisione; transparencë dhe integritet në përzgjedhje
Infrastruktura publike	Krijimi i fushave të hapura basketbolli; ndarje buxheti për hapësira komunitare
Çështje juridike	Sqarimi i pronësisë së stadiumit “Xhemajl Isufi”; lirimi i hapësirave nga “Diagonia”

[27] https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/07/Raporti-performances-Komunale-2023-final-18.07.2024.pdf
[28] https://mapl.rks-gov.net/performanca-komunale/
[29] https://mitroviceejugut.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/

Bazuar në të dhënat e periudhës janar 2024 – mars 2025, krahasuar aktivitetet e planifikuara për periudhën 2024–2026, reflektohet një trend i ngadaltë dhe kërkohen masa direkte. Në këtë objektiv janë paraparë gjithsej dhjetë aktivitete, të ndërlidhura me ndërtimin e infrastrukturës sportive dhe kulturore me qasje gjinore, promovimin e modeleve të suksesshme të grave dhe vajzave në art e sport, mbështetjen me subvencione të klubeve dhe organizatave të udhëhequra nga gra, si dhe inkurajimin e pjesëmarrjes së vajzave në gara dhe aktivitete publike. Qëllimi i përgjithshëm është rritja e dukshmërisë dhe përfshirjes aktive të grave në jetën kulturore dhe sportive në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

Interpretimi i trendit tregon se:

- Vetëm 3 nga 10 aktivitete janë zbatuar pjesërisht deri në mars 2025, konkretisht aktiviteti 3.2.2 (mbështetja e klubeve sportive për vajza), aktiviteti 3.2.4 (renovimi i ambienteve sportive), dhe aktiviteti 3.2.10 (organizimi i garave sportive për vajza dhe gra). Megjithatë, edhe këto aktivitete janë zbatuar pa një plan të qartë të barazisë gjinore dhe pa dokumentim të mjaftueshëm. Veçanërisht te ndarja e subvencioneve sportive, është vërejtur pabarazi e theksuar, pasi nga 231,750-euro gjithsej, vetëm 43,500-euro (18.8%) janë dedikuar për klubet e vajzave/gra, ndërsa 81.2% për klubet e djemve/burrave.
- 3 aktivitete janë në proces përgatitor për vitin 2025 (3.2.5, 3.2.6 dhe 3.2.7), por nuk ka asnjë raport mbi planifikimin financiar, përmbajtjen konkrete apo afatet e finalizimit. Për më tepër, mungon koordinimi ndërmjet drejtorive për kulturë, sport dhe barazi gjinore për të garantuar përmbajtje gjithëpërfshirëse.
- 4 aktivitete të tjera nuk kanë shënuar asnjë progres deri më tani, përfshirë ndërtimin e fushave sportive afër liqenit (3.2.1), funksionalizimin e qendrës së xhudos (3.2.3), publikimin e broshurës për gratë me kontribute (3.2.7) dhe promovimin e sportit për vajza në shkolla (3.2.9). Këto mungesa lidhen me pengesa administrative, mungesë të fondeve dhe moszgjidhje të statusit të pronësisë së parcelave.

Bazuar në këtë, edhe pse në fazë të hershme të zbatimit trendi i përgjithshëm i arritjes për Objektivin Specifik 3.2 mbetet nën nivelin e pritshëm për vitin 2024 dhe tremujorin e parë të vitit 2025. Synimi për rritjen e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në aktivitetet sportive dhe kulturore nuk është përkthyer në zbatim të strukturuar, të matshëm dhe të balancuar gjinor. Ndarja e fondeve favorizon në mënyrë disproporcionale klubet e burrave dhe mungesa e dokumentimit e bën të pamundur matjen reale të përfituesve dhe ndikimit të aktiviteteve. Kjo gjendje nënvizon dy sfida kryesore: e para, është mungesa e planifikimit të dedikuar dhe ndarjes së drejtë të subvencioneve për klubet dhe nismat që përfshijnë vajza dhe gra; e dyta, është mungesa e dokumentimit të aktiviteteve dhe matjes së ndikimit sipas treguesve gjinorë të përcaktuar.

3.3.2.1. Matrica e Monitorimit - Objektivi Specifik 3.2

Objektivi Specifik	Aktiviteti	Treguesi i Performancës	Rezultati i Arritur (2024 – Mars 2025)	Burimi i Verifikimit	Komente nga Monitorimi
3.2. Promovimi i modeleve të suksesshme të grave, të rejave dhe vajzave në art, kulturë dhe sport	3.2.1 Ndërtimi i fushave sportive tek Liqeni Akumulues	1 fushë multifunksionale	Jo – çështje e pazgjidhur e pronësisë	-	Mungesë koordinimi institucional; pengesat pronësore;
	3.2.2 Mbështetje për klube sportive të vajzave dhe grave	Numri dhe shuma e klubeve të mbështetura	4 klube të vajzave/femrave me 43,500€; 39 klube	Dokumente financiare, FB DKRS	Pabarazi evidente në ndarje; mungon ndarja sipas kategorive
	3.2.3 Ndërtimi i qendrës së Xhudos	Qendër funksionale për të dy gjinitë	Jo – nuk ka filluar ndërtimi; Ministria përgjegjëse	Njoftime publike	Komuna ka ofruar parcelën; procesi i vonuar nga MKRS
	3.2.4 Investime në hapësira sportive të aksesueshme dhe të	Hapësirat e përmirësuara sipas standardeve	Renovime në Omni Sport: ulëse, dysheme, ngjyrosje	Foto në FB, dokumentim DKRS	Nuk ka të dhëna të ndara sipas përdoruesve;
	3.2.5 Furnizimi i bibliotekës me tituj të autoreve gra dhe	Numri i titujve të shtuar	Jo – planifikuar për gjashtëmujorin e dytë 2025	-	Mungon plan konkret publik deri në këtë fazë;
	3.2.6 Funksionalizimi i bibliotekës së re	Biblioteka funksionale	Po – e përfunduar, hapja parashikohet në qershor 2025	Postime në FB	Nevojitet ndarje e rolit komunal për operim dhe mirëmbajtje
	3.2.7 Publikimi i broshurës për gratë me kontribute	Broshura e publikuar	Jo	-	Aktiviteti nuk ka filluar; mungojnë fondet dhe planifikimi;
	3.2.8 Takime me të rinjtë mbi rolin e grave në histori	Numri i takimeve të zhvilluara	Takime të realizuara me të rinj, por jo mbi broshurën	Postime FB muzeu, DKRS	Aktivitetet ekzistojnë, por nuk janë në linjë me objektivin specifik
	3.2.9 Promovimi i sportit tek vajzat dhe zbulimi i talenteve	Numri i talenteve të identifikuara	Jo të raportuara; aktivitete sportive janë mbështetur	-	Nuk ka sistem për identifikim dhe raportim të talenteve
	3.2.10 Gara sportive për vajzat dhe gratë	Numri i garave të zhvilluara	4 gara të ndryshme në 2025: futboll, basketboll, volejboll	Raporte DKRS, postime	Realizuar pjesërisht; duhet shtuar komponenta gjinore në raportim.

3.4. Objektivi 4. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese

3.4.1. Rritja e qasjes së grave, të rejave, e vajzave në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime cilësore shëndetësore dhe të shëndetit seksual e riprodhues.

Referuar raportit nga dëgjimet buxhetore 2024, përkatësisht dëgjimit të tretë buxhetor të mbajtur më 18 korrik 2024[1], i dedikuar sektorit të shëndetësisë në Komunën e Mitrovicës së Jugut, profesionistët shëndetësorë dhe përfaqësues të institucioneve parashtruan kërkesa konkrete që pasqyrojnë nevojat aktuale infrastrukturore dhe funksionale të qendrave mjekësore familjare. Kërkesat kryesore përfshijnë përmirësimin e kushteve në QMF dhe AMF, përfshirë rinovimin e hapësirave të brendshme dhe të jashtme, vendosjen e klimave dhe pajisjeve për ngrohje e ftohje, rezervarë uji, pjerrina për persona me aftësi të kufizuara dhe siguri për ruajtjen e barnave. Po ashtu, u kërkua sigurimi i stafit për mirëmbajtje, pajisje moderne për pastrim, si dhe investime për kushte më të mira higjienike dhe funksionale në objekte. Këto kërkesa theksojnë mungesat bazike në infrastrukturë, nevojën për mirëmbajtje sistematike dhe domosdoshmërinë e përfshirjes së këtyre prioriteteve në buxhetin 2025–2027

Tabela – Kërkesat kryesore nga dëgjimi buxhetor për Shëndetësi [30]

Fusha	Kërkesat Kryesore
Infrastrukturë	Rinovim i objekteve QMF/AMF (Bair 1, Bair 2, Fidanishtë, Kçiq); vendosje dritaresh, dyersh, ngjyrosje
Pajisje teknike	Vendosje e klimave, ngrohje, ventilim, rezervarë uji, sistem ftohës për barna
Qasje dhe siguri	Pista për persona me nevoja të veçanta, rrethojat dhe sigurimi i ambientit të jashtëm
Mirëmbajtje	Pajisje moderne për pastrim dhe një punëtor për mirëmbajtje në objekte shëndetësore
Pajisje shëndetësore	Aparat për ftohjen e ujit të pijshëm në repartin e stomatologjisë

Referuar Raportit të Punës nga Drejtoria për Shëndetësi gjatë vitit 2024[31] ka ndërmarrë disa aktivitete që kontribuojnë në përmirësimin e qasjes në shëndetin seksual dhe riprodhues. Këto përfshijnë: Realizimin e fushatave vetëdijësuese për të rinjtë rreth shëndetit riprodhues, kryesisht në bashkëpunim me shkollat dhe organizatat partnere; Shërbime të ofruara nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në fushën e shëndetit seksual, si: këshillimi për planifikim familjar; Trajnime të stafit shëndetësor për trajtimin e çështjeve të ndjeshme në lidhje me të drejtat seksuale, me fokus të veçantë për të rinjtë dhe gratë; Ofrimi i kontrolleve sistematike për gratë në moshë riprodhuese përmes programeve të skriningut (kontrolle për kancerin e qafës së mitrës).

[30] https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/03/Raporti-i-Punes-i-Drejtorise-per-Shendetesi-2024-1.pdf
[31] https://mitroviceejugut.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/

Të dhënat referuar Shtojcës së Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor[32]:

Në QKMF, gratë përbëjnë shumicën e stafit me 64.6%, por përfitojnë vetëm 35% të buxhetit të pagave. Ndërkohë, burrat përbëjnë 35.4% të stafit, por përfitojnë 65% të buxhetit.

Struktura gjinore e stafit dhe pagave në QKMF (2024)

Gjinia	Numri i stafit	Përqindja e stafit	Paga dhe mëditje (€)	Përqindja nga buxheti
Gra	192	64.60%	1,006,267	35.00%
Burra	105	35.40%	1,868,782	65.00%
Totali	297	100%	2,875,049	100%

Bazuar në të dhënat e periudhës janar 2024 – mars 2025 për zbatimin e kësaj objektive, mund të konstatohet përparim vetëm në disa aktivitete dhe me mungesë dokumentimit dhe ndarjes së të dhënave për grupet e synuara. Në këtë objektiv janë paraparë gjithsej dhjetë aktivitete, të ndërlidhura me informimin dhe vetëdijesimin e komunitetit mbi të drejtat seksuale dhe riprodhuese, shpërndarjen e mjeteve parandaluese, promovimin e shërbimeve të ndjeshme gjinore në kujdesin shëndetësor, ofrimin e shërbimeve parandaluese (Pap Test, mamografi), subvencionimin për rastet sociale dhe ofrimin e kujdesit paliativ në shtëpi.

Interpretimi i trendit tregon se:

- 4 nga 10 aktivitete janë zbatuar në mënyrë të plotë deri në mars 2025, përkatësisht: aktiviteti 4.1.3 (fushata “Tetori Rozë”), 4.1.4 (mamografitë falas), 4.1.6 (vizitat për lehona dhe vetëdijesimi i baballarëve) dhe 4.1.9 (subvencionimi i rasteve sociale terminale). Këto aktivitete kanë rezultuar me përfshirje të mirë të komunitetit dhe janë të dokumentuara me të dhëna mbi përfituesit dhe efektet.
- 4 aktivitete janë zbatuar pjesërisht (4.1.1, 4.1.7, 4.1.8, 4.1.10), me përfshirje të kufizuar, mungesë të statistikave të detajuara dhe dokumentim të pamjaftueshëm mbi ndikimin real. P.sh., aktiviteti 4.1.1 ka përfshirë vetëm disa sesione me gra, pa ndarje sipas moshës apo etnisë; aktiviteti 4.1.8 për Pap Test nuk raporton numra vjetorë.
- 2 aktivitete nuk janë zbatuar ose mungojnë të dhënat e zbatimit (4.1.2 për shpërndarjen e mjeteve kontraceptive dhe 4.1.5 për sesionet për personelin shëndetësor), çka tregon për mungesë të koordinimit institucional dhe përgatitjes administrative.
- Bazuar në këtë situatë, trendi i përgjithshëm i arritjes për Objektivin Specifik 4.1 ka një përmbushje të pjesshme të synimeve për vitin 2024 dhe tremujorin e parë të vitit 2025. Pavarësisht përpjekjeve të drejtorisë për shëndetësi në disa segmente, si kujdesi paliativ dhe shërbimet diagnostikuese për gratë, mungesa e qasjes së koordinuar për edukimin gjinor dhe raportimi i dobët i aktiviteteve për shëndetin seksual e riprodhues pengon matjen e efektivitetit dhe përfshirjes së grupeve të ndryshme.

[32] https://mitroviceejugut.rks-gov.net/buxheti-2/

Raporti i Punës DSH (2024) [33]

Aktiviteti	Parashikuar	Realizuar
Takime informuese	30 takime, 450 persona	7 sesione, 35 gra
Shpërndarja e mjeteve kontraceptive	7,500 mjete/vit	Pa të dhëna
Fushata “tetori rozë”	10 takime, 200 gra	S’ka të dhëna numerike
Shërbimi mamografik falas	500 gra	99 gra
Sesione për personelin shëndetësor	12 sesione, 300 persona	Nuk ka informacion
Vizita në familje për nënat dhe fëmijët 0–3 vjeç	-	1,728 vizita;
Sesione për kancerin e qafës së mitrës në zona rurale	15 sesione, 225 gra	4 sesione, 22 gra
Subvencionim për pap test	480 ekzaminime/vit	22 gra
Subvencione për raste sociale me sëmundje terminale	900 përfitues/vit	695 përfitues
Kujdesi shtëpiak paliativ	6,000 qytetarë/vit	35,883 vizita

[33] https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/03/Raporti-i-Punes-i-Drejtorise-per-Shendetesi-2024-1.pdf

3.4.1.1. Matrica e Monitorimit - Objektivi Specifik 4.1

Objektivi Specifik	Aktiviteti	Treguesi i Performancës	Rezultati i Arritur (2024 – Mars 2025)	Burimi i Verifikimit	Komente nga Monitorimi
4.1. Rritja e qasjes së grave, të rejave, e vajzave në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime cilësore shëndetësore dhe të shëndetit seksual e riprodhues	4.1.1 Takime informuese për të drejtat seksuale e riprodhuese	30 takime, 450 persona të informuar	7 sesione informuese, 35 gra pjesëmarrëse	Raporte QKMF, FB	Të dhënat nuk janë të ndara sipas moshës/etnisë; mungojnë listat
	4.1.2 Shpërndarja e mjeteve kontraceptive	7500 mjete/vit	Pa të dhëna të sakta për 2024	-	Nevojitet sistem raportimi me ndarje gjinore dhe sasi
	4.1.3 Fushata “Tetori Rozë”	10 takime, 200 gra; marsh, fletushka	Marshim, seminarë, shpërndarje materialesh	Raporte, FB, fotografi	Aktivitet i mirëdokumentuar; mungon ndarja statistikore
	4.1.4 Shërbimi mamografik falas	500 gra në vit	99 gra të shërbyera në 5 ditë gjatë tetorit	Raport bashkëpunimi QKMF–Avicena	Niveli i mbulueshmërisë shumë më i ulët se objektivi
	4.1.5 Sesione për personelin shëndetësor mbi qasjen gjinore	12 sesione, 300 persona	Jo të raportuara	-	Mungojnë të dhëna; s’ka dëshmi për realizim
	4.1.6 Vizita në familje për nënat dhe fëmijët 0–3 vjeç	Numri i vizitave; përfshirja e baballarëve	1,728 vizita; 342 baballarë të përfshirë	Raporte QKMF, FB	Dokumentim i mirë; mungojnë ndarjet sipas fëmijëve vajza/djem
	4.1.7 Sesione për kancerin e qafës së mitrës në zona rurale	15 sesione, 225 gra	Aktivitet i nisur – shpërndarje fletushkash, 4 sesione, 22 gra	FB DSH, Njësia e Edukimit	Pjesëmarrje e ulët; mungojnë ndarjet sipas moshës dhe etnisë
	4.1.8 Subvencionim për PAP test	480 ekzaminime/vit	22 gra kanë caktuar termine për PAP test	Raporte QKMF, FB	Niveli i realizimit shumë më i ulët; nevojitet promovim më i madh
	4.1.9 Subvencione për raste sociale me sëmundje terminale	900 përfitues/vit	695 përfitues, 80,000€; gra 65%, burra 35%	Dokumente financiare, FB	Dokumentim i mirë; të dhëna të ndara sipas gjinisë
	4.1.10 Kujdesi shtëpiak paliativ	6,000 qytetarë/vit	35,883 vizita familjare në 2024	Raporte shëndetësore	Shërbim me mbulim të gjerë; mungojnë ndarjet gjinore

4. Konkluzionet

1. **Zbatim i pjesshëm dhe mungesë e dokumentimit** - nga gjithsej 4 objektiva strategjikë, 7 nën-objektiva dhe 66 aktivitete në PLVBGJ, edhe pse në faze të hershme, mund të konstatohet një zbatim i pjesshëm. Edhe në rastet kur kanë ndodhur aktivitetet dokumentimi mbetet sfidues.
2. **Mungesë koordinimi ndër-sektorial** – zyrtari/ja për barazi gjinore në komunë është i emëruar, por funksioni nuk ka arritur të shtrihet me një rol ndër-sektorial. Komiteti për Barazi Gjinore, si trup këshillëdhënës i Kuvendit Komunal, nuk ka qenë funksional gjatë periudhës së monitorimit, dhe nuk janë mbajtur takime të rregullta, as nuk ka pasur ndonjë raport vjetor të punës së tij.
3. **Perspektiva gjinore e kufizuar në planifikimin dhe buxhetimin komunal**

- Korniza Afat-Mesme Buxhetore dhe Buxheti Vjetor nuk përmbajnë analizën e perspektivës gjinore. Nuk ekziston ndonjë format i vlerësimit të ndikimit gjinor.
- Shtojca për Buxhetim të Përgjegjshëm Gjinore, mbetet në korniza formale, pa analizë të qartë të perspektivës gjinore në buxhet.
- Subvencionet, nuk reflektojnë numrat e përfituesve sipas gjinive dhe buxhetet e planifikuara në shtojcën e BPGJ;

4. **Përfaqësimi i ulët i grave në strukturat vendimmarrëse komunale** - nga të dhënat e përmbledhura në dokumentacionin e Kuvendit Komunal dhe komisioneve të përkohshme/përhershme të tij:

- Gratë përfaqësojnë rreth 15% të pozitave udhëheqëse në administratën komunale.
- Në drejtori dhe pozita udhëheqëse politike, gratë përfaqësohen pak mbi 22%;
- Ndërkaq në administratë komunale, përfaqësimi është më i lartë 40.29%; në arsim dhe shëndetësi ka një përqindje të njëjtë me 64,64%;

5. **Ofrimi i shërbimeve për gratë e margjinalizuara është i përgjithshëm dhe jo i dedikuar**

- Nuk janë evidentuar aktivitete të dedikuara për gratë e papuna, gratë me aftësi të kufizuara, ose gratë nga komunitetet jo-shumicë.
- Në dokumentet e fushës se arsimi dhe të shëndetësisë nuk ka ndarje të plotë të përfituesve sipas gjinisë dhe statusit social;

6. **Planifikimi dhe raportimi nuk reflekton vlerësimin nga perspektiva gjinore** – në planifikimet komunale dhe raportime komunale ka vetëm të dhëna te pjesshme të ndara sipas gjinisë. Kjo pamundëson vlerësimin e ndikimit të politikave nga perspektiva gjinore dhe pengon përpjekjet për buxhetim të ndjeshëm gjinor. Mungojnë indikatorët sektorial mbi progresin e zbatimit të PLVBGJ, ende nuk janë zhvilluar platforma apo mjete për planifikim apo ndarjen e përfituesve sipas gjinisë.

5. Rekomandime

1. **Krijimi i një Plani Operacional të Zbatimit të PLVBGJ**

- Të përgatitet një plan pune vjetor me aktivitete të qarta, afate, përgjegjësi të ndara, indikatorë dhe burime buxhetore për secilin aktivitet të PLVBGJ.
- Komuna duhet të alokojë një buxhet të veçantë në buxhet për zbatimin e barazisë gjinore, të menaxhuar nga Zyrtari/ja për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financave.

2. **Funksionalizimi i Komitetit për Barazi Gjinore dhe forcimi i mandatit të zyrtarit për Barazi Gjinore**

- Komiteti të thërrasë takime periodike brenda vitit; të përgatisë plane pune dhe të publikojë raport vjetor.
- Roli i Zyrtarit/es për Barazi Gjinore të kalojë nga funksion administrativ në funksion ndër-sektorial koordinues, me të drejtë qasje në grupet punuese të buxhetimit dhe planifikimit komunal.

3. **Integrimi i barazisë gjinore në planifikimet dhe financimet komunale**

- Të rishikohen dokumentet ekzistuese për të përfshirë analizën gjinore në sektorët e infrastrukturës, zhvillimit ekonomik, arsimit, shëndetësisë, punësimit dhe mirëqenies.
- Të integrohen objektiva, masa dhe veprime në dokumentet strategjike komunale dhe të kategorizohen në Kornizat Afat-Mesme dhe Buxhetet Vjetore si të tilla.

4. Z**hvillimi dhe përdorimi i statistikave gjinore dhe indikatorëve për matje të progresit**

- Çdo drejtori të dorëzojë të dhëna të ndara sipas gjinisë në planifikim si dhe për përfituesit e projekteve dhe shërbimeve publike.
- Të hartohet një set indikatorësh të matshëm për secilin objektiv të PLVBGJ, për shembull: % e grave përfituese nga subvencionet, % e pjesëmarrjes së grave në takime publike;

5. **Organizimi i fushatave për vetëdijesim dhe përfshirje në media dhe shkolla**

- Komuna të bashkëpunojë me programet dhe agjencitë në fushën e barazisë gjinore për zhvillimin e moduleve të barazisë gjinore në shkolla.
- Të dizajnohen fushata mediale dhe aktivitete publike me fokus në rolin e grave në politikë, ekonomi, edukim dhe familje.

6. **Forcimi i bashkëpunimit me OSHC-të dhe komunitetin lokal**

- Krijimi i një forumi të përbashkët midis komunës dhe organizatave të grave dhe të rinjve për konsultime periodike mbi zbatimin e PLVBGJ.
- Të zhvillohen projekte të përbashkëta me organizatat për ofrim trajnimesh, mentorime dhe shërbime për gra dhe vajza.

7. **Rritja e transparencës dhe raportimit publik mbi barazinë gjinore**

- Të publikohet një raport vjetor i progresit të PLVBGJ dhe të publikohet në uebfaqen e komunës.
- Raportet të përfshijnë të dhëna gjinore, buxhete të dedikuara dhe masa për përmirësim.

Mitrovica Women's Association for Human Rights (MWAHR)

Kontakt

Bulevardi "Isa Boletini"
Mitrovicë, 40000

I web: www.mwahr.org
I e-mail: mitrovica.wahr@gmail.com
I mob:+383 (0)49 130 365